

DOKUMENTET PËR APLIKIM

- a) kërkesa për pajisjen me dublikatë, ku të shprehet edhe arsyesa pse kërkohet dublikatë;
- b) Vetëdeklarimi, ku individi të deklarojë se njeh dhe angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e profesionit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit. Gjithashtu, të deklarojë se nuk është i dënuar nga organet e gjyqësorit në lidhje me ushtrimin e profesionit të vlerësimit;
- c) vërtetim, nga organet tatimore, për shlyerjen nga individi të të gjitha detyrimet tatimore, të lëshuar jo më vonë se 1 muaj nga aplikimi (vërtetim nga drejtoria rajonale tatimore dhe nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore pranë bashkisë respektive).

+ Pagesa e tarifës.

Dorëzimi, pranimi i aplikimit

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj, sipas kësaj rregulloreje, dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.

2. Dokumentet për licencë duhet të janë:

- a) origjinale ose fotokopje të noterizuara;
- b) në gjuhën shqipe ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar;
- c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridikzionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistencë e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet ose nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare e-Albania, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim, i cili shkarkohet nga portali ose mund të disponohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë së Zhvillimin Urban.

Kushte paraprake e kufizime

1. Individu/shoqëria/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të plotësojë kushtin që të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore për çështje që kanë lidhje me ushtrimin e aktivitetit profesional si vlerësues dhe të mos jetë në periudhën e ekzekutimit të një mase administrative të mëparshme, kundrejt licencës profesionale për vlerësim.

2. Individu/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon të licencohet, duhet të njohë dhe të angazhohet të zbatojë kushtet, rregullat dhe standardet e vendosura nga dispozitat në fuqi për ushtrimin e këtij profesi dhe, në mungesë të tyre, t'u referohet standardeve evropiane të vlerësimit.

3. Individu/vlerësuesi i shoqërisë, që kërkon dublikatë të licencës, duhet të ketë shlyer te gjitha detyrimet tatimore.

VKM nr. 712, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme"